



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më, 23.03.2021 merr këtë

V E N D I M

PËR BARTJEN E BUXHETIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2020 NË VITIN 2021

I.

MIRATOHET Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2020 në vitin 2021.

II.

Shuma e mjeteve të bartura, si në pikën I të këtij vendimi, është **34,347,176.33 €**.

III.

Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, destinohet si në vijim:

1. *Investimet kapitale, shuma prej 27,623,176.33 €;*
2. *Subvencione dhe transfere, shuma prej 6,724,000.00 €;*

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore.

V.


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-400/03-54135/21, më 23.03.2021

KRYESUESI I KUVENDIT  
Agim Kuleta



## A r s y e t i m

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi dhe Ligjin mbi buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Nga viti 2020 në vitin 2021, barten mjetet në shumë prej **34,347,176.33 €**.

Ndryshimet dhe bartja e mjeteve sipas fushave nga viti 2020 në vitin 2021, është orientuar në këto kategori ekonomike:

- **Investimet kapitale** - mjete në shumë prej **27,623,176.33 €**. të mbetura nga viti 2020. Detajet për këto projekte janë të paraqitura në tabelat përcjellëse.
- **Subvencione dhe transfere** - mjete në shumë prej **6,724,000.00 €**. Detajet janë të paraqitura në tabelat përcjellëse.